

Të shtrish dorën midis shkollave...

Nga 15 deri në 22 mars 2014, një ekip nga Shkolla "Ylber" (Tirana), pesë mësuese të ciklit të ulët, të ftuar nga Kolegji Lestonnac i Barcelonës, bëmë vizitë pune tek ky kolegji.

Një ekip na shoqëroi nga dita e parë dhe u njoh me ambientet e kolegjit, ekipin drejtues, dhe organizimin e shkollës.

Gjatë këtyre ditëve u trajtuan tema që kishin të bënin me njësi didaktike, "interioridad" (jeta e brendshme), puna në grupe e shumë dinamika të përdorura në raste të ndryshme.

Gjithashtu, ne bëmë një prezantim të jetës së shkollës tonë para bashkësive të Shoqërisë së Zonjës Mari dhe ekipit të profesorit.

Ishte era e parë që ne bëmë një vizitë në një shkollë jashtë vendit dhe vume re se sa të përbashketa kemi si shkolla të Shoqërisë së Zonjës Mari edhe pse në vende të ndryshme e me kultura të ndryshme. Kjo na bëri të ndiheshim pjestarë të një familje të madhe pavarësisht distancave.

Shumë interesant ishte edhe vizita në kolegjin e Badalonës. U njohem me veshtirësitë dhe veçoritë e punës aty. Gjatë këtyre ditëve patëm kontakte të shumta dhe shkëmbyem eksperiencat tona me mësuesit e kolegjit Major.

Mikpritja, fryme e bashkëpunimit, gatishmëria për të ndihmuar ishin prezente në çdo moment dhe na bënë të ndiheshim shumë mirë.

Koha që e mjaftueshme dhe e planifikuar mjaft mirë për të na dhënë mundësinë që përveç punës të vizitonim mjaft vende turistike të Barcelonës.

Për ne ishte një eksperiencë e re por ndihma për shkollën tonë në Shqipërinë ka qënë gjithmonë prezente. Tashme kolegji dhe mësuesit në Barcelonë janë pjesë e shkollës "Ylber", çdo ditë e më shumë.

Falenderojmë të gjithë ata që na mundësuan këtë bashkëpunim dhe shkëmbim pervoje, e në veçanti ata që na qëndruan përkrah në çdo moment: Lluís, Joan, Agusti, Anna, Dolors, Pura, Maria, Montserrat si dhe Shoqëria e Zonjës Mari në Shqipëri dhe në Barcelonë.

Yllka Doçi, Shkolla Ylber (Tirana)